



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0367

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga **XX** duke vendosur sipas ankesës së OE " HIDRO PROJECT " SH.P.K., kundër Vendimit për dhënie të një kontrate lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i pishinës së mbyllur gjysmë Olimpikë-Rishpallje” me numër të prokurimit 631-23-4052-5-1-1, iniciuar nga Kuvendi Komunal-Deçan në cilësinë e autoritetit kontraktues (AK), më 03/08/2023, mori këtë:

Vendim

1. Aprovohet si pjesërisht e bazuarankesa e OE “Hidro Project” Sh.P.K. me nr. 367/23, e datës 08.06.2023, kundër Vendimi i AK i komunikuar me Njoftimin e datës 22.05.2023, lidhur me aktivitetin të prokurimit me titull “Ndërtimi i pishinës së mbyllur gjysmë Olimpikë-Rishpallje” me numër të prokurimit 631-23-4052-5-1-1, Vërtetohet.

2. Lejohet kthimi i mjeteve të deponuara në emrin e tarifës ankimore, kurse ankuesi ka të drejtë që në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi, të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën mjetet konfiskohen dhe kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës. konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 26.04.2023, Komuna e Deçanit duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka publikuar Njoftimin për Kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i pishinës së mbyllur gjysmë Olimpikë-Rishpallje” numër prokurimi 631-23-4052-5-1-1. Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës për punë dhe me

vlerë të parashikuar të kontratës 998,321.00 €.

Me 22.05.2023, Autoriteti Kontraktues ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin e tij/sajë, përmes të cilit ka shpallur fitues Grupin e Operatorëve Ekonomik (GOE) “VB. Tofaj & Niva Construction Sh.P.K”.

Me 29.05.2023, OE "Hidro Project" Sh.P.K ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Vendimit të cituar si më sipër, e cila është refuzuar si e pa bazuar me Vendimin e AK të datës 30.05.2023.

Me datë 08.06.2023, OE (me të dhëna si më sipër) ka parashtruar ankesë në OSHP, kundër Vendimit të cituar si më sipër të AK.

Me rastin e shqyrtimit paraprak,

Paneli Shqyrtues konstatoi se, ankesa në rastin konkret, është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK, çdo palë e interesuar mund të parashtoj ankesë në OSHP pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji. Meqë parashtruesi ka statusin e palës së interesuar në kuptim të nenit 4, paragrafi 1.26, kurse ankesa përmban elementet qenësore të parapara me nenin 111, të Ligjit të cituar do të thotë se e njëjta i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave të cituara dhe bien nën kompetencat e kësaj Organi në kuptim të nenit 105 të LPP.

OSHP ka angazhuar ekspertin shqyrtues të prokurimit, që në pajtim me nenin 113 dhe 114 të LPP-së, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore. Lidhur me këtë, me 15.06.2023, OSHP ka pranuar Raporti i Ekspertit Shqyrtues me rekomandimet si vijon:

Ankesa të refuzohet si e pabazuar;

Të mbetet në fuqi vendimi i AK;

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët me ç ‘rast AK ka deklaruar se pajtohet me rekomandimet e ekspertit, ndërsa ankuesi ka deklaruar se nuk pajtohet. Paneli konstatoi se nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, lidhur me paragrafin 1.75, të nenit 4 të LPP dhe njëherësh analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se pretendimet e palëve, parashtruesit e tyre, provat dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritues lidhur me çështjen në rastin konkret, Paneli Shqyrtues konsideron se kushte për të vendosur në kuptim të nenit 24

paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP, lidhur me nenin 4, paragrafi 1.75 të LPP

- Administrimi dhe vlerësimi i provave -

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues janë parashtruar përmes ankesës si në vijim:

Eksperti gjatë shqyrtimit të kësaj lënde dhe dokumentacionit të dorëzuar vëren se:

Pretendimi i parë (I) - Operatori ekonomik ankues pretendon se tenderuesi i propozuar për kontratë nuk e plotëson kërkesën e dosjes së tenderit mbi kapacitetin teknik dhe profesional ku kërkohen projekte të natyrës së njëjtë në tri (3) vitet e fundit nga data e njoftimit të kësaj kontrate me vlerëjo më të vogël se 1,400,000.00 Euro, të vërtetuara me anë të procesverbaleve apo pranimeve teknike.

Pretendimi i dytë (II) - Operatori ekonomik ankues pretendon se tenderuesi i propozuar për kontratë ka ndërhyrë në dokumentin e para-masës duke ndryshuar një pikë të para-masës, përkatësisht pikën 10 duke e shtuar nëdokumentacionin e dorëzuar të dosjes së tenderit edhe një fushë me emërtimin “Punët e Zdrukthëtarisë”.

Pretendimi i tretë (III) - “Operatori ekonomik ankues pretendon se tenderuesi i propozuar për kontratë ka prezantuar si menaxher të projektit z. F.... K... (emri në shkresë të lëndës) biografia (CV) e të cilit nuk e plotëson kërkesën e AK meqë nuk është shënuar që ky inxhinier ka mbikëqyr apo ka qenë pjesë e ndonjë projekti pas diplomimit.

Prandaj bazuar në pohimet si më sipër, ankuesi konsideron se AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 6, 7, 59, 60 dhe 61 të LPP dhe ka kërkuar nga Paneli Shqyrtues që të miratohet si e bazuar ankesa ashtu që aktiviteti i prokurimit të kthehet në Rivlerësim.

Lidhur me pretendimin e parë (I) ankimor, eksperti shqyrtues pas shqyrtimit të kësaj lënde dhe dokumentacionit të OE të rekomanduar vëren:

1. Ekziston procesverbal, reference si dhe kontrata mbi pranimin teknik të punëve të kryera për projektin "Ndërtimi i pendës dhe kanalit të ujitjes për nevojat e fermerëve në fshatrat Zahaq, Ramun dhe Gllaviqicë - Komuna e Pejës" në vlerë prej 155,555.55 Euro e datës 05.10.2022;
2. Reference nga Komuna e Gjakovës e datës 11.05.2021 për realizimin e punëve në kuadër të kontratës me numër 632-20-1110-5-1-1 për projektin me titull "Rregullimi i shtratit të lumit Krena" në vlerë prej 833,915.48 Euro;
3. Kontrata dhe procesverbal i komisionit për pranimin teknik i dt. 27.05.2022 për projektin Ndërtimi i pendës për ujitje në fshatin Vranoc, Deçan nga K. Deçanit me vlerë 131,118.73 €.
4. Tek projekti "Ndërtimi i Qendrës për Kulturë, Turizëm dhe Agrobiznes në vlerë prej 777,777.77 Euro, ka reference të datës 15.01.2020 por vetëm për 3 situacione të përfunduara, andaj kjo kontratë nuk nënkupton që është përfunduar dhe nuk

mund te merret parasysh;

5. Reference nga Komuna e Gjakovës për kryerjen e punëve te projektit me titull: "Sanimi i pendave dhe kanaleve te ujitjes ne zonat rurale" e datës 22.11.2022 ne vlere prej 69,597.16Euro ;
6. Reference nga Komuna e Deçanit mbi përfundimin e projektit kontrate kornize i cili ka përfunduar sipas kontratës me date 31.05.2022 me titull Rekonstruimi i rrugëve te Bjeshkëve ne Deçan me vlere prej 291,117.47 Euro;
7. Procesverbal mbi pranimin teknik te projektit "Asfaltimi i rrugës Junik-Prilep-Drenoc" i datës 12.07.2021 kontrate ne vlere prej 258,920.00 euro;
8. Procesverbal i pranimi teknik për projektin "Ndërtimi i Ambulantes se Mjekësisë Familjare-Gramaqel i dates:22.11.2021 kontrate kjo ne vlere prej 44,662.05 euro;
9. Reference mbi kryerjen e punëve nga OE ne konzorcium "Niva Construction shpk" për projektin "Investime ne Objektin Banesor ne rr. Eqrem Çabej"- Prishtine me vlere prej 102,617.03 euro;
10. Reference mbi kryerjen e punëve nga OE ne konzorcium "Niva Construction shpk" per projektin "Renovimi i lokaleve ne rrugën Adrian Krasniqi-Prishtine". me vlere prej 191,953.01 euro.

Sipas të thënave më sipër, eksperti shqyrtues ka analizuar pretendimet e ankuesit me ç ‘rast ka gjetur se pretendimet ankimore janë të paqëndrueshme përfshirë edhe pretendimin e parë të operatorit ekonomik ankues.

Lidhur me pretendimin e dytë (II) ankimor,eksperti shqyrtues pas vlerësimit të pretendimeve ankimore ka gjetur vlerësuar si në vijim “Sipas kërkesës se OE ankues i cili i është drejtuar për opinion zyrës se KRPP-se me kete rast ka marre këtë përgjigje: ku thuhet qe ky dokument/paramasë, nuk bën te ndryshohet ne përmbajtje përveç vendosjes se Logos nga ana e OE, duhet te plotësohet ashtu sic eshte bere nga ana e AK.

Po të shohim në detaje dhe në dokumentin brenda saj, vërejmë që këto paramsa dhe paralogari nuk janë prekur dhe as ndryshuar nga OE në fjalë por tek rekapitullimi apo tabela përmbledhëse është shtuar nr. 10 punët e zdrukthetarisë, që eksperti mendon që kjo do duhej të bëhej që nga fillimi edhe nga ana e AK. ë bazë të kësaj duke parë që tek kjo pikë nuk është prekur asgjë nga Operatori i rekomanduar dhe në përmbajtjen e saj gjithcka është në rregull sa i përket përshkrimi i çmimeve po ashtu edhe i sasive. Pra vërehet qe edhe tek cmimi i kësaj pike por edhe te totali i çmimeve nuk ka ndërhyrje dhe as ndryshime. Eksperti konsideron qe ky pretendim i OE ankues është i pabazuar.

Lidhur me pretendimin e tretë (III) ankimor, eksperti shqyrtues pas vlerësimit të pretendimeve ankimore ka gjetur vlerësuar si në vijim “Po të shohim me kujdes pretendimin mbi atë se Menaxheri i Projektit nuk e plotëson kërkesën e dosjes së tenderit: Dëshmia 3. CV-ja për projektet e realizuara pas diplomimit- duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit, diploma e noterizuar Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë projekt, si dhe Referenca për punët e mëparshme në lëmin e kërkuar të lëshuar nga punëdhënësi. Vërejmë që i cekuri më lartë z. F... K... (emri në shkresë të lëndës) është i punësuar në kompaninë në fjalë që nga viti 2012 dhe është ende aktiv si dhe vazhdon edhe më tutje të punojë ku edhe shihet kontrata e tij në afat të pacaktuar. Është e vërtetë që në CV e tij janë të detajuara projektet veç e veç me detajet e nevojitura por që ju mungon vetëm shumica e atyre projekteve. Por po të shikojmë më poshtë në dokumentin e bashkëngjitur në dosjen e dorëzuar i emëruar "Vërtetim" ku është dokument i lëshuar nga OE për Menaxherin e Projektit, që vërteton për punët e kryera dhe të mbikëqyrura ku specifikohet vendi dhe shumica e projekteve ashtu siç është kërkuar në Dosje të Tenderit. Sipas të thënave më sipër, eksperti shqyrtues ka analizuar dhe ka trajtuar pretendimet e operatorit ankues me ç rast ka gjetur se pretendimet ankimore janë të paqëndrueshme.

Paneli vëren se nga kuadri i shkresave të kësaj lënde, në raportin e ekspertit nuk janë analizuar pohimet ankimore lidhur me faturën e buldozerit si dhe dudin doganor të cilindrit. Mirëpo, bazuar në diskrecionin dhe vlerësimin e tij të pavarur, Paneli konsideron (nën supozimin e arsyeshëm) se të dyja këto janë analizuar nga AK, në kuptim të nenit 59, në procesin e ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve, i cili adresohet si kompetence dhe përgjegjësi e AK. Nga ana tjetër, Paneli konsideron se dokumentet e cituara si më sipër nuk e përfaqësojnë karakterin dhe/ose rëndësinë substanciale të dosjes së tenderit dhe/ose të vendosjes meritore. Sidoqoftë, për çdo fakt dhe/ose provë, Paneli ka marrë në konsideratë çdo pohim nga të dyja palët dhe në kontesktin e përgjithshëm të kësaj çështje, mbështeti Raportin e ekspertit shqyrtues dhe rekomandimet e tij/sajë është i bazuar në shpjegime dhe dëshmi jo kontestuese në dhënien e opinionin e tij.

- Konstatimet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në kundërshtim me dispozitat për të pretendohet nga operatori ekonomik ankues. Në rastin konkret nga raporti i ekspertit shqyrtues, dëshmitë e prezantuara nga operatori ekonomik

ankues, dokumentet e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit, është gjetur se të gjitha pretendimet ankimore janë të pabazuara në tërësi.

Duhet theksuar se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për panelin shqyrtues dhe çdo raport i tillë vlerësohet dhe analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, pohimeve të palëve, akteve dhe veprimeve të tyre, natyrisht duke e pasur parasysh edhe natyrën e shkeljeve eventuale në raport me qëllimin dhe rrjedhën e një aktiviteti të prokurimit.

Prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli Shqyrtues e mbështet ndonjë raport apo ndonjë rekomandim të ekspertizës, i takon gjykimit të pavarur dhe profesional të panelit ashtu siç i adresohen kompetencat e tilla sipas nenit 105 të LPP. Megjithatë duhet kujtuar se për çdo dokument dhe/ose provë relevante (përfshirë dhe faturën dhe dudin e cituar më sipër) i takon domosdo AK që para aktit të nënshkrimit të kontratës ti verifikoj për hir të sigurisë dhe etikës publike të institucionit.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik duhet të refuzohet si e pabazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur për të vërtetuar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues – Komuna e Deçanittë datës 22.05.2023 lidhur me aktivitetin të prokurimit me titull “Ndërtimi i pishinës së mbyllur gjysmë Olimpikë-Rishpallje” me numër të prokurimit 631-23-4052-5-1-1 si dhe të konfiskohet tarifa e ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankues bazuar në nenin 31 par. 5 të Rregullores së Punës së OSHP ndërsa mjetet të kalojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës.

Panelit Shqyrtueska vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 të Rregullores së Punës së OSHP.

Lidhur me pikën 2 të këtij aktvendimi paneli shqyrtues vendosi për faktin se vlerësimit të dy dokumenteve për OE të rekomanduar (siç është shpjeguar më sipër) do të bëhet para

nënshkrimit të kontratës nga ana e AK.

Prandaj bazuar në të lartë cekurat dhe administrimi i provave dhe duke ju referuar nenit 98, 99, lidhur me nenin 105 të LPP, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vjosa Gradinaj

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI KOMUNAL-DEÇAN**
- **OE - " HIDRO PROJECT " SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: